

## MBRONI FËMIJËN TUAJ

Vaksina do ta mbrojë fëmijën tuaj kundër gripit dhe komplikimeve serioze si bronkiti dhe pneumonia.



MË MIRË SE SA  
TË SËMURET  
NGA GRIPI!

## MBRONI VETEN, FAMILJEN DHE MIQTË TUAJ

Me vaksinimin e fëmijës Tuaj do i mbron edhe gjyshërit, anëtarët e familjes dhe miqtë që nuk mund të vaksinohen.

## PSE FËMIJA DUHET TË VAKSINOHET ÇDO VIT?

Viruset e gripit ndryshojnë vazhdimisht dhe nuk është e pazakontë që çdo vit të shfaqet një lloj i ri i virusit të gripit. Vaksinimi para çdo sezioni është mënyra e vetme dhe më e sigurtë e parandalimit të gripit.

## E RËNDËSISHME!

VAKSINIMI PËR FËMIJËT NGA 6 MUAJ  
DERI NË 5 VJET ËSHTË **FALAS!**

Për fëmijët nën 9 vjet që vaksinohen për herë të parë rekomandohet që të marrin dy doza me një interval prej 4 javësh dhe më pas të vazhdojnë të vaksinohen një herë në vit.

### CAKTONI TERMIN PËR VAKSINIM NËPËRMJET PLATFORMËS ONLINE!

Caktimi i termineve për vaksinim me vaksina falas bëhet nëpërmjet ueb-faqes  
[www.vakcinacija.mk](http://www.vakcinacija.mk)

Me plotësimin e formularit ju regjistroheni për vaksinim drejtpërdrejt në sistemin Termini Im. Me anë të një mesazhi SMS ju do të informoheni për datën dhe orën e saktë të vaksinimit në pikën e vaksinimit që e keni zgjidhur gjatë regjistrimit.

Përveç këtyre vaksinave, ju mund të vaksinoheni me vaksina komerciale kundër gripit sezonal në Qendrën më të afërt të Shëndetit Publik pa caktuar paraprakisht një termin.

Çfarë dini për GRIPIN?

**SI TA MBRONI MË MIRË FËMIJËN  
TUAJ?**

**VAKSINOJENI ATË!**



## PSE FËMIJËT DUHET TË VAKSINOHEN KUNDËR GRIPIT?

Gripi është sëmundje e shkaktuar nga virusi i gripit (influenza) dhe që prek rrugët e sipërme të fryshtimit (hundën dhe fytin), ndërsa në formë më të rënda edhe rrugët e poshtme të fryshtimit (bronket). Gripi mund të jetë një sëmundje shumë e pakëndshme për fëmijët që shkakton temperaturë, lodhje, dhimbje të muskujve dhe nyjeve, hundë të zënë, kollë të thatë dhe dhimbje të fytit. Fëmijët fillojnë të ndjehen më mirë pas një javë. Disa fëmijë mund të kenë nevojë të shtrohen në spital.

## CILAT JANË PËRFITIMET NGA VAKSINA?

Fëmijët nën moshën 5 vjet kanë një shkallë më të lartë të hospitalizimeve për shkak të gripit!

Gjithashtu vaksina zvogëlon mundësinë që anëtarët e tjerë në familjen tuaj të sëmuren, siç janë gjyshërit ose personat me sëmundje kronike.

Mund t'ju ndihmojë të shhangni marrjen e pushimit mjekësor nga puna ose nga aktivitete të tjera që të kujdeseni për fëmijën tuaj ose për veten tuaj nëse sëmurenit nga gripi.

## SI TRANSMETOHET GRIPI?

Gripi është një sëmundje ngjitëse që përhapet drejtëpërdrejt nga një njeri tek tjetri, kryesisht nëpërmjet pikave të imëta që personi i infektuar i nxjerr gjatë kollitjes dhe teshtitjes, ose në mënyrë indirekte nëpërmjet kontaktit me sipërfaqet përreth të cilat ai i ka prekur ose gjësendet që i ka përdorur.

Symptomat e sëmundjes shfaqen 1 deri në 4 ditë pasi virusi të ketë hyrë në trup. Shumica e njerëzve mund ta transmetojnë virusin te një person tjeter nga një ditë para shfaqjes së simptomave deri në 5-7 ditë pas shfaqjes së sëmundjes. Kjo do të thotë që një person mund ta transmetojë virusin përpara se ta kuptojë se është i infektuar.



## A MUND TË MERRET VAKSINA KUNDËR GRIPIT NË TË NJËJTËN KOHË ME VAKSINA TË TJERA?

PO. Fëmija juaj mund ta marrë vaksinën kundër gripit së bashku me vaksinat e tjera të detyrueshme.

## A KA VAKSINA KUNDËR GRIPIT EFEKTE TË PADËSHIRUARA?

Efektet e padëshiruara të vaksinave kundër gripit janë të lehta në krahasim me pasojat e mundshme serioze të infektimit me virusin e gripit.

Efekti më i shpeshtë i padëshiruar është reaksiuni lokal në vendin e aplikimit në formë të dhimbjes, ndjeshmërisë, skuqjes dhe/oseënjtjes. Mund të shfaqet edhe dhimbje e kokës, lodhje, djersitje, humbje oreksi, irritim, dhimbje stomaku ose barkqitje, por të gjitha këto nuk zgjasin shumë dhe kalojnë brenda 24 deri në 48 orëve.



VAKSINIMI ËSHTË MËNYRA MË EFEKTIVE PËR T'I PARANDALUAR KOMPLIKIMET NGA GRIPI.